



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

23.05.2024, Prishtinë

Thirrje për aplikim

Bazuar në Thirrjen publike për Projekt-Propozimeve për Dokumentim dhe Promovim në Fushën e Sportit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në përputhje me Nenin 8, paragrafin 3.2 të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, ftojmë organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile/njohësit e fushave sport, rini, art, kulturë dhe trashëgimi kulturore, të aplikojnë për të marr pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë:

- përfaqësues nga OJQ-të
- përfaqësues në cilësinë e njohësit të fushave përkatëse

Të drejtë aplikimi kanë:

1. Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
2. Njohësit e fushës së sportit.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një CV;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;

Përfaqësuesit e lartë përmendur do të jenë anëtarë të Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve nga thirrja publike " Dokumentim dhe promovim në Fushën e Sportit" të pranuar nga organizatat jo qeveritare (OJQ) sipas thirrjes publike të datës: 22.03.2024.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: nuraj.kurtesh@rks-gov.net deri me datën 30.05.2024, dhe të shkruhet në **subjekt pozitën për anëtar të komisionit për të cilin aplikoni.**

MKRS-ja do të vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe do të përzgjedhë një kandidatë nga OJQ-të dhe një njohës të fushave të lartë përmendura, që do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike të datës 22.04.2024 të publikuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Pagesa për pjesëmarrje në komision për secilin anëtarë të përzgjedhur do të jetë 500.00 €.